



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS -
UNIVERSITETSKA BOLNIČKA I KLINIČKA SLUŽBA KOSOVA -
THE HOSPITAL AND UNIVERSITY CLINICAL SERVICE OF KOSOVO
ARKIVI QENDROR - CENTRAL ARCHIVE - GENERAL ARCHIVE

Nr. i njësis org	✓	№. i reg	2802
org. jec		Org. mat	
org. anal		Org. no	
№. i seq	7	Data	20.10.22
Pr. i. n.		Emri	
Titulli			

LL. PËNË, PËNËNJA - LIMITED

**Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova
Hospital and University Clinical Service of Kosovo**

Kolegji Universum

Në bazë të nenit 62 paragrafit 3 të ligjit Nr.04/L-125 Për Shëndetësi, nenit 13 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Rregullores për Përcaktimin e Kushteve dhe Organizimin e Praktikës Klinike dhe Ushtrimeve Për Studentët e Institucioneve Private të Arsimit të lartë në SHSKUK e miratuar me datë 27.05.2022 me nr.prot.1397/2, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës dhe Kolegji Heimerer duke u mbështetur në vullnetin e lirë të tyre, më 20.10.2022 në Prishtinë Republika e Kosovës, lidhin këtë:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR

REALIZIMIN DHE ORGANIZIMIN E PRAKTIKËS KLINIKE DHE USHTRIMEVE PËR STUDENTËT E KOLEGJIT UNIVERSUM NË SHËRBIMIN SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS.

Palët e marrëveshjes:

- Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës këtu e tutje SHSKUK, me adresë:
Lagjia e Spitalit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, i përfaqësuar nga u.d.
Drejtori i Përgjithshëm Dr.Pranvera Zejnullahu-Raçi, Phd.
dhe**
- Kolegji Universum, me adresë: Magjistranja Prishtinë-Ferizaj km 10, Republika e
Kosovës, i përfaqësuar nga Drejtoresha për Operacione të Biznesit znj.Arlinda
Qehaja**

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është ofrimi përkatësisht marrja e shërbimeve për realizimin praktikës klinike dhe ushtrimeve për studentët e Kolegjit Universum në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës këtu e tutje QKUK.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj marrëveshje zbatohen për studentët e Kolegjit Universum, programet e studimit të të cilëve janë të licencuara dhe të akredituara sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës të cilët kryejnë praktikën klinike dhe ushtrimet sipas kësaj marrëveshje në QKUK.

Dispozitat e kësaj marrëveshje zbatohen edhe për stafin e njësisë organizative të QKUK-së në të cilën zhvillohet praktika klinike dhe ushtrimet sipas kësaj marrëveshje dhe mentorët klinik të angazhuar në pajtim me këtë marrëveshje.

Neni 3

Objekti i marrëveshjes

Objekt i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është përcaktimi i të drejtave dhe detyrave që dalin nga realizimi i praktikës klinike dhe ushtrimeve zbatohen për studentët e Kolegjit Universum, programet e studimit të të cilëve janë të licencuara dhe të akredituara sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës të cilët kryejnë praktikën klinike dhe ushtrimet sipas kësaj marrëveshje në QKUK.

Neni 4

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zgjat një vit, përkatësisht deri në 19.10.2023.
2. Afati i kësaj marrëveshje bashkëpunimi, nga paragrafi 1. i këtij neni, mund të zgjatet me aneks marrëveshje të re.

Neni 5

Praktika Klinike në SHSKUK

1. QKUK merr përsipër që të mundësojë kryerjen e praktikës dhe ushtrimeve për studentët e programit si më poshtë të Kolegjit Universum, sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje dhe legjislacionin në fuqi:
2. Praktika klinike sipas paragrafit 1 të këtij neni organizohet në pajtim të plotë me planin e punës të QKUK-së.
3. Praktika klinike në QKUK për studentët e programeve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni të Kolegjit Universum, organizohet çdo ditë sipas plan programit të hartuar nga mentori klinik në bashkëpunim me Kolegjin Universum dhe të aprovuar nga Drejtori për Arsim dhe Shkencë i SHSKUK-së.

- 3.1. Praktika klinike dhe ushtrimet në QKUK nuk mund të organizohet gjatë orarit të rregullt të punës (07:00 - 15:00).
- 3.2. Praktika klinike dhe ushtrimet në QKUK mund të organizohen çdo ditë duke filluar nga ora 15:00 deri në orën 20:00.
- 3.3. SHSKUK bënë caktimin e hapsirave për mbajtjen e praktikës në koorindinim me Kolegjin Universum.
4. Kohëzgjatja e praktikës klinike përcaktohet me nenin 4 të kësaj marrëveshje.

Neni 6 **Obligimet e SHSKUK-së**

1. QKUK është e obliguar që të ofrojë kushtet dhe hapsirat e nevojshme në bazë të kapaciteteve poseduese që mundësojnë kryerjen e praktikës klinike sipas kësaj marrëveshje.
2. QKUK, përmes Drejtorit për Arsimit dhe Shkencë, mbikqyrë organizimin dhe koordinimin e punëve dhe mbarvajtjes së punës praktike për studentët e Kolegjit Universum.
3. QKUK, me pëlqimin e studentit/es, mund të angazhojë atë në procesin e punës, kryesisht në funksione ndihmëse të cilat përkojnë me zhvillimin dhe njohuritë e studentit.
4. Studentët që kryejnë praktike klinike dhe ushtrime, sipas kësaj marrëveshje, nuk kanë të drejtë të ndërmarrin asnjë veprim profesional në pacientët e QKUK-së, pa mbikqyrjen e mentorit.
5. QKUK, mbanë evidencë dhe lëshon vërtetim për kryerjen e punës praktike për studentin/en që ka përfunduar me rregull praktikën klinike.

Neni 7 **Obligimet e Kolegjit Universum**

1. Kolegji Universum përgatitë dhe harton listën e studentëve që do të kryejnë praktikën në QKUK dhe mban përgjegjësi për të.
2. Nëse studentët e Kolegjit Universum, gjatë kryerjes së praktikës klinike dhe ushtrimeve në QKUK, shkaktojnë dëm në aparaturat apo hapsirat e QKUK-së, Kolegji Universum është i obliguar që të bëjë kompensimin e atij dëmi në tërësi sipas evidentimit dhe dokumentimit të dëmit të shkaktuar.
3. Kolegji Universum ka për obligim që të caktojë personin përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e punëve, i cili në bashkëpunim me Drejtorin për Arsimit dhe Shkencë në kuadër të SHSKUK-së, do të harmonizojnë planin e kryerjes së praktikës klinike dhe ushtrimeve me planin e punës në QKUK.
4. Kolegji Universum është përgjegjës për kompensimin e të lënduarit përkatësisht trajtimin e sëmundjes së tij të cilin student/ja e ka fituar gjatë realizimit të praktikës klinike apo ushtrimeve në QKUK.

Neni 8

Kushtet e përgjithshme për realizimin e praktikës klinike në QKUK

1. Kolegji Universum duhet të njoftojë të gjithë studentët, të cilët do të realizojnë praktiken klinike dhe ushtrimet në SHSKUK, për detyrat, përgjegjësitë dhe sjelljet e tyre gjatë realizimit të detyrave të tyre përkatëse.
2. Drejtori për Arsim dhe Shkencë i SHSKUK-së, sipas kësaj marrëveshje dhe personi përgjegjës nga Kolegji Universum, merren vesh për harmonizimin e plan prorgamit realizimit të praktikës për studentët e Kolegjit Universum.
3. Organizimi i praktikës klinike sipas kësaj marrëveshje nuk duhet të pengojë procesin e punës në njësitë përbërëse dhe organizative në QKUK.
4. QKUK merr përsipër organizimin e pjesës praktike në lëmin e lëndëve paraklinike dhe klinike në njësitë përbërëse të tij për studentët e Kolegjit Universum.
5. Studentët e Kolegjit Universum, të cilët kryejnë praktikën klinike në QKUK, sipas kësaj marrëveshje, kanë për obligim që gjatë kryerjes së praktikës të mbajnë veshur uniforma standarde të cilat duhet të kenë llogon e Kolegjit Universum.
6. Drejtori për Arsim dhe Shkencë në SHSKUK, në bashkëpunim me koordinatoren e caktuar nga Kolegji Universum, caktojnë mentorët dhe stafin tjetër sipas nevojës për organizimin e praktikës klinike dhe ushtrimeve për studentët e Kolegjit Universum në pajtim me legjislacionin në fuqi.
7. Drejtori për Arsim dhe Shkencë në SHSKUK, përmes mentorëve klinik, përcjell vijueshmërinë e studentëve të programeve përkatëse të Kolegjit Universum dhe në rast të më shumë se tre (3) mungesa pa arsye dhe më shumë se dhjetë (10) mungesa të tjera, atëherë studenti/ja nuk mund të marrë vërtetimin për kryerjen e praktikës klinike në QKUK.

Neni 9

Kushtet e veçanta për realizimin e praktikës klinike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës - QKUK

1. Numri i lejuar i studentëve të Kolegjit Universum që kryejnë praktikë klinike dhe ushtrime në QKUK, përcaktohet me vendimin përkatës të Agjensionit të Kosovës për Akreditim (vendimi bashkëngjitur kësaj marrëveshje).
2. Palët e kësaj marrëveshje, pajtohen që shërbimet e praktikës klinike në QKUK realizohen me pagesë.
3. Pagesa për shërbimet e praktikës klinike dhe ushtrimeve për studentët e Kolegjit Universum bëhet në xhirologarinë e SHSKUK-së (bashkëngjitur kësaj marrëveshje) dhe bëhet si kompensim për shërbimet e marrura profesionale.
4. Për studentët e programit infermieri, mami, fizioterapi, logopedi, laborant, psikologji dhe radiologji të cilët kryejnë praktikë klinike në SHSKUK, Kolegji Universum duhet ti paguajë SHSKUK –së shumën prej njëqinddhjetë (110) euro për një (1) student për një (1) vit akademik.

5. Për studentët e programit stomatologji të cilët kryejnë ushtrime në SHSKUK, Institucioni Privat i Arsimit të Lartë duhet ti paguajë SHSKUK-së shumën prej një mijë e pesëqind (1500) euro për një (1) student për një (1) vit akademik.

5.1.Pagesa sipas këtij paragrafi vlen vetëm për studentët që kryejnë praktikën klinike dhe ushtrimet në Qendrën Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK).

5.2.Studentet e programit të stomatologjisë të cilën kryejnë praktikën klinike dhe ushtrimet në lëndët nga mjekësia e përgjithshme në SHSKUK, duhet të paguajnë shumën prej dyqind (200) euro për një vit akademik.

6. Për studentët e programit farmaci të cilët kryejnë praktikë ushtrime në SHSKUK, Institucioni Privat i Arsimit të Lartë duhet ti paguajë SHSKUK-së shumën prej (400) euro për një vit akademik.
7. Pagesa sipas këtij neni duhet të bëhet para fillimit të mbajtjes së praktikës klinike dhe ushtrimeve.
8. Në rast të dykuptimisë së dispozitave të parapara në këtë marrëveshje, atëherë do të vlejnjë dispozitat e parapara në Rregulloren nr.prot: 1397/2 të datës 27.05.2022 e miratuar nga Bordi Drejtues i SHSKUK-së

Neni 10

Mentorët klinik

1. Mentorët klinik që angazhohen sipas kësaj marrëveshje, duhet që të jenë në marrëdhënie pune me SHSKUK.
2. Mentorët klinik që angazhohen sipas kësaj marrëveshje, nuk mund të kryejnë shërbimin e mentorimit për studentët e Kolegjit Universum gjatë kohës kur janë në orarin e rregullt të punës me QKUK.
3. Kohezgjatja e kontratës për mentor klinik duhet të jetë në përputhje me kohëzgjatjen e kësaj marrëveshje.
4. Kolegji Universum, është i obliguar që të paguajë angazhimin e mentorit përkatës, në pajtim me orët e angazhimit.
5. Emërimi i mentorëve bëhet pesëmbdhjetë (15) ditë para fillimit të semestrit përkatës.
6. Mentorët klinikë, sipas kësaj marrëveshje angazhohen sipas Rregullos nr.prot: 1397/2 të datës 27.05.2022. Lista e mentorëve klinik propozohet nga Kolegji Universum dhe miratohet nga Drejtori për Arsim dhe Shkencë në SHSKUK.

Neni 11

Mbikqyrja e zbatimit të marrëveshjes

1. Autoritet mbikqyrës i zbatimit të kësaj marrëveshje, për QKUK-në është Drejtori për Arsim dhe Shkencë i SHSKUK-së, Drejtori i Klinikës përkatëse dhe personi përgjegjës sipas nenit 5 paragrafi 2 i Rregullos nr.prot: 1397/2 të datës 27.05.2022.
2. Për Kolegjin Universum koordinatori i caktuar sipas kësaj marrëveshje.

Neni 12

1. Nëse palët e kësaj marrëveshje, dëshirojnë që të ndryshojnë kushtet nga kjo marrëveshje, përfshirë shkëputjen e saj, atëherë, palët mund t'i bëjnë këto ndryshime me marrëveshjen e dy palëve, me njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike.
2. Në rast kontesti të mundshëm në mes të palëve të kësaj marrëveshje lidhur me dispozitat e kësaj marrëveshje, kompetente për zgjidhjen e tij është Gjykata Themelore në Prishtinë.

Neni 13

1. Kjo marrëveshje është e hartuar në katër (4) kopje origjinale nga dy (2) për secilën nga palët e saj.

Neni 14

Dispozitat shfuqizuese

Dispozitat e kësaj marrëveshje shfuqizojnë çdo marrëveshje tjetër të lidhur për qëllimin e njejtë mes palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje.

Neni 15



Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi më 20.10.2022.

PALËT NËNSHKRUESE:



Dr. Pranvera Zejnullahu-Raci, Phd.

u.d. Drejtör i Përgjithshëm, SHSKUK



znja Arlinda Qehaja

Drejtoreshë për Operacione të Biznesit



Republika e Kosovës



**Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government**



**Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - (SHSKUK)
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova - (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo - (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Univerzitetski Klinički Centar Kosova -
University Clinical Centre of Kosova**

Numri i xhirologarisë, Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK):

NLB Banka: 1000400070005903

SHKUPIT
[Signature]